



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 12 par. 12.1, dhe 17 pika r) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008 , dhe neneve 9 pika r) , 20 par 20.1, dhe 51 pika b) dhe pika dh) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 15.09.2023, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM

PËR PËRCAKTIMIN E FESTIVALIT “MËRGATA FEST & SPORTS” SI FESTIVAL TRADICIONAL I KOMUNËS SË LIPJANIT

I.Me këtë Vendim përcaktohet që festivali “Mërgata Fest & Sports”, të jetë festival tradicional i Komunës së Lipjanit.

II. Festivali tradicional “Mërgata Fest & Sports “do të mbahet gjatë sezonës verore, çdo vit.

III. Objektivat e këtij festivali janë kryesisht zhvillimi i aktiviteteve të ndryshme nga fusha e kulturës, rinisë dhe sportit në shenjë respekti për mërgimtarët e ardhur për pushime nga shtetet e ndryshme të botës si dhe me qëllim të argëtimit të gjithë qytetarëve të Komunës së Lipjanit.

IV. Për organizimin, kohzgatjen dhe mbajtjen e këtij Festivali do të kujdeset Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport i Komunës së Lipjanit.

V.Mjetet financiare për organizimin dhe mbajtjen e këtij Festivali do të sigurohen nga buxheti i Komunës.

VI. Ky Vendim hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në Ëebfaqen e Komunës
Nr. 15-644/01-53377

Lipjan, më 15.09.2023

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi